R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1272/7prot. Tiranë, më 25.09.2026

V E N D I M

Nr. 40, datë 25.09.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Qendra "Media Amfora", përfaqësuar nga av. , (në vijim "Ankuesi"), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 1272 prot., datë 11.05.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, me anë të nëpërmjet kërkesës datë 25.02.2026, depozituar nëpërmjet shërbimit postarmailto:info@durres.gov.al, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni, si vijon:

1. Informacion nëse specialistë të institucionit kanë zhvilluar vizita në terren, inspektime ose monitorime në zonën ku është realizuar projekti ***"Manastiri Resort"****, në Gjirin e Manastirit, Bashkia Sarandë;*

2. Në rast se janë zhvilluar vizita ose monitorime, kërkojmë:

- datat e vizitave;

- përbërjen e grupeve të specialistëve;

- kopje të raporteve, procesverbaleve ose konstatimeve të hartuara;

3. Kopje të çdo raporti monitorimi arkeologjik të realizuar gjatë punimeve ndërtimore të projektit;

4. Çdo raport teknik ose shkencor mbi ndikimin e ndërhyrjeve ndërtimore në potencialin arkeologjik të zonës;

5. Dokumentacion mbi rekomandimet profesionale ose masat e propozuara nga institucioni për mbrojtjen e vlerave arkeologjike gjatë ose pas realizimit të projektit;
6. Çdo komunikim institucional i dërguar autoriteteve shtetërore lidhur me gjëndjen arkeologjike të zonës pas ndërhyrjeve ndërtimore.

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ankuesi, Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it të datës 02.04.2026, ka thyer përgjigje duke u shprehur se: *"...në vijim të kërkesës suaj, IKTK ka përgatitur dosjen përkatëse. Duke qenë se projekti është aktualisht në proces zhvillimi dhe ka një kohëzgjatje relativisht të konsiderueshme, dokumentacioni i kërkuar nga ana Juaj përbëhet në total nga 15 kopje/dokumente të lidhura me këtë proces. Përpara se dokumentacioni tju vihet në dispozicion në formë digjitale, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr. 5, datë 27.08.2025, "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore", pika 8, "Tarife për pajisje me kopje në A4 në formë digjitale", subjekti duhet të paraqiteni pranë IKTK për të tërhequr mandatin e arkëtimit.*
Vetëm pas dorëzimit të mandatit të pagesës, IKTK do të vendosë në dispozicionin Tuaj, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar...", dhe nëpërmjet e-mail-it të datës 16.04.2026 ka kthyer përgjigje duke u shprehur se: *"...Udhëzimi i përbashkët nr. 5, datë 27.08.2025, i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Për miratimin e tarifave dhe mënyrës së perdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore", aplikohet për shërbimet e ofruara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në perputhje me kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", i ndryshuar. Në pikën 5 të tij evidentohet se: "Përjashtohen nga pagesa e tarifave të gjitha organet publike dhe shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, të cilat janë në rolin e investitorit/zhvilluesit apo të objekteve publike", çka do të thotë se për subjektin "Media Amfora" tarifa është e aplikueshme pavarësisht pretendimit të saj që parashtron në e-mail. Subjekti duhet të paraqitet pranë IKTK për të tërhequr mandatin për arkëtim në lidhje me kërkesën që ka dërguar. Vetëm pas dorëzimit të mandatit të pagesës, IKTK do të vendosë në dispozicionin Tuaj, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar...".*

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 1272 prot., datë 11.05.2026, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që*

të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 1272/1 prot., datë 14.05.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 21.05.2026.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 823/1 prot., datë 21.05.2026, i ka kthyer përgjigje ankuesit dhe Zyrës së Komisionerit, duke sqaruar se: *"...në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr.5, datë 27.08.2025, i Ministrit të Financave dhe ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Për miratimin e tarifave dhe mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore"...i ka kërkuar subjektit të paraqitet për të tërhequr faturën për arkëtim...".*

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me anë të *email*-it të datës 03.06.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1272/3 prot., datë 03.06.2026, ka vijuar ankimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 1272/5 prot., datë 21.07.2026, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua datë 23.07.2026 me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi, Qendra "Media Amfora", përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z. dhe av. , rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. , në cilësinë e juristes pranë Autoritetit Publik dhe të koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe z. , konfirmuan qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në shkresën kthim përgjigje nr. 823/1 prot., datë 21.05.2026.

Në vijim të seancës dëgjimore, Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it të datës 04.08.2026, është shprehur se: *"...Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, date 23.07.2026, ju bëjmë me dije se: IKTK, në zbatim të rekomandimit të dhënë gjatë seancës, i është drejtuar Ministrisë së linjës me kërkesë për interpretim lidhur me zbatimin e Udhëzimit të tarifave për sa i përket vënies në dispozicion të dokumentacionit teknik. Aktualisht jemi në pritje të këtij interpretimi, i cili do të orientojë mënyrën e trajtimit të kësaj pjese të kërkesës. Gjatë verifikimit të dokumentacionit të administruar në institucion është konstatuar një mospërputhje ndërmjet kërkesës së administruar nga institucioni dhe kërkesës së cilës iu referua subjekti kërkues gjatë seancës dëgjimore. Në këtë drejtim, evidentojmë se korrespondenca elektronike e depozituar nga institucioni gjatë seancës dëgjimore është paraqitur pikërisht për të provuar përmbajtjen e kërkesës së administruar dhe komunikimin e zhvilluar ndërmjet palëve. Nga kjo korrespondencë rezulton qartë se*

kërkesa e administruar, ka si objekt vënien në dispozicion të kopjeve të relacioneve teknike, ndërsa në dokumentacionin e paraqitur në kuadër të ankesës administrative evidentohet një kërkesë me përmbajtje të ndryshme, në të cilën kërkohet edhe informacion mbi zhvillimin e inspektimeve, datat e tyre dhe përbërjen e grupeve të punës. Po ashtu, vlerësojmë të rëndësishme të evidentojmë se subjekti kërkues nuk i është drejtuar në asnjë rast drejtpërdrejt Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, por kërkesat janë përcjellë nëpërmjet Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të Ministrisë së linjës. Për këtë arsye, identifikimi i saktë i kërkesës së përcjellë dhe i asaj që është bërë objekt i ankesës administrative merr rëndësi thelbësore për vijimin e procedurës dhe për dhënien e një përgjigjeje të plotë e të saktë. Për sa më sipër, lutemi të na sqaroni se cila kërkesë përbën objektin e shqyrtimit në procedurën administrative, pasi nga verifikimet tona nuk rezulton që kërkesa së cilës iu referua subjekti kërkues gjatë seancës të jetë administruar nga institucioni. Vlerësojmë se ky sqarim është i domosdoshëm, pasi objekti i procedurës administrative duhet të jetë i qartë dhe i identifikueshëm edhe për autoritetin publik ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Në rast se ankesa administrative është mbështetur mbi një kërkesë që nuk rezulton të jetë administruar nga institucioni, është e nevojshme të përcaktohet qartë se cila kërkesë përbën objektin e shqyrtimit, në mënyrë që institucioni të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën e tij procedurale për t'u shprehur mbi objektin e ankesës dhe, njëkohësisht, të përmbushë në mënyrë korrekte detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për të drejtën e informimit dhe rekomandimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore…".

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik për mospërputhjen ndërmjet kërkesës së administruar prej tij dhe kërkesës së paraqitur në kuadër të ankimit administrativ, nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës rezulton se vetë Autoriteti Publik, në shkresën depozituar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 823/6 prot., datë 23.07.2026, ka pohuar se: *"...IKTK është njohur me kërkesën nëpërmjet e-mail-it të datës 27.02.2026 dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Trashëgimisë Kulturore pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Pas delegimit të kërkesës në strukturat përgjegjëse pranë IKTK-së, dhe përgatitjes së dosjes përkatëse, me datë 03.03.2026 bëjmë me dije që subjekti duhet të paraqitet pranë I KTK pë të tërhequr faturën e arkëtimit..."*. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se kërkesa e datës 25.02.2026, është administruar nga Autoriteti Publik dhe përbën objektin e kësaj procedure administrative.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik **për sa i përket kushtëzimit të vënies në dispozicion të informacionit/dokumentacionit me pagesën e tarifës së parashikuar në Udhëzimin e përbashkët nr. 5, datë 27.08.2025,** nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet*

e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj". Në kuptim të këtij parashikimi, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, ndaj i nënshtrohet detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj për garantimin e së drejtës për informim.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike"*.

Neni 16 i LDI parashikon shprehimisht se: *"1. Në qoftë se autoriteti konstaton se trajtimi i një kërkese për informim ka kosto të lartë ose se trajtimi i saj kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji, autoriteti publik njofton menjëherë për këtë kërkuesin dhe i propozon mundësinë e ndryshimit të kërkesës së tij. 2. Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni. Kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkesës, duke i treguar kërkuesit adresën e saktë të faqes ku informacioni gjendet në formë elektronike. 3. Pas marrjes së kërkesës për informim, autoriteti publik llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe, sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuesin. Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave."* si dhe neni 7 i ligjit nr. 45/2022 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Aksesin në Dokumente Zyrtare"", i cili parashikon se: "*1. Shqyrtimi i dokumenteve zyrtare në ambientet e një autoriteti publik është pa pagesë. Kjo nuk i pengon Palët të caktojnë tarifa për këto shërbime të ofruara nga arkivat dhe muzetë. 2. Një tarifë mund të caktohet ndaj kërkuesit për një kopje të dokumentit zyrtar, e cila duhet të jetë e arsyeshme dhe të mos tejkalojë kostot aktuale të riprodhimit dhe dorëzimit të dokumentit. Tarifat e pagesave duhet të publikohen...."*

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme rezulton se duhet bërë dallimi ndërmjet tarifave të vendosura për shërbimet që IKTK ofron në ushtrim të kompetencave të tij sipas legjislacionit të posaçëm dhe kostove që mund t'i ngarkohen kërkuesit kur ushtron të drejtën për informim sipas LDI-së. Në rastin konkret, vënia në dispozicion e informacionit/dokumentacionit të prodhuar ose të mbajtur nga Autoriteti Publik, kur kërkohet në ushtrim të së drejtës për informim, nuk përbën në vetvete një shërbim të posaçëm të IKTK-së që mund t'i nënshtrohet automatikisht tarifave të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët nr. 5, datë 27.08.2025. Kërkesa duhet të trajtohet sipas regjimit të posaçëm të parashikuar nga LDI për aksesin në informacionin publik.

Për rrjedhojë, çdo shumë që mund t'i ngarkohet kërkuesit në kuadër të trajtimit të kërkesës për informacion duhet të përcaktohet sipas nenit 16 të LDI-së dhe të lidhet me kostot e riprodhimit dhe, sipas rastit, të dërgimit të informacionit. Kjo kosto duhet të jetë e

arsyeshme dhe të mos tejkalojë kostot faktike të riprodhimit dhe dorëzimit të dokumentacionit, në përputhje edhe me nenin 7 të ligjit nr. 45/2022. Për këtë arsye, kushtëzimi i aksesit në dokumentacionin e kërkuar me pagesën e tarifës së përcaktuar për shërbimet e IKTK-së, pa vlerësuar paraprakisht natyrën e kërkesës si kërkesë për informacion dhe pa përllogaritur kostot sipas regjimit të LDI-së, nuk është në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar, për aq sa prodhohet ose mbahet nga Autoriteti Publik, përbën informacion publik, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".* Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, përveç rasteve kur aksesi në të kufizohet në përputhje në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë, pika 3 e nenit 3 të LDI-së parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Gjithashtu, ankuesi është media, e cila nëpërmjet kërkesës së paraqitur, synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Në këtë kontekst, roli i medias në kërkimin dhe përcjelljen e informacionit me interes publik gëzon mbrojtje edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në çështjen *"Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë (aplikimi nr. 37374/05, datë 14.04.2009"* vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e "mbikëqyrësit shoqëror", duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe lidhet ngushtë me garantimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Për rrjedhojë, kërkesa për informacion duhet të trajtohet në përputhje me garancitë, procedurat dhe kufizimet e parashikuara në LDI.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Media Amfora”, me nr. 1272 prot., datë 11.05.2026, ndaj Autoritetit Publik “Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik **“Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”** për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit, sipas kërkesës datë 25.02.2026, konkretisht: *“1. Informacion nëse specialistë të institucionit kanë zhvilluar vizita në terren, inspektime ose monitorime në zonën ku është realizuar projekti **“Manastiri Resort”**, në Gjirin e Manastirit, Bashkia Sarandë; 2. Në rast se janë zhvilluar vizita ose monitorime, kërkojmë: - datat e vizitave; - përbërjen e grupeve të specialistëve; - kopje të raporteve, procesverbaleve ose konstatimeve të hartuara; 3. Kopje të çdo raporti monitorimi arkeologjik të realizuar gjatë punimeve ndërtimore të projektit; 4. Çdo raport teknik ose shkencor mbi ndikimin e ndërhyrjeve ndërtimore në potencialin arkeologjik të zonës; 5. Dokumentacion mbi rekomandimet profesionale ose masat e propozuara nga institucioni për mbrojtjen e vlerave arkeologjike gjatë ose pas realizimit të projektit; 6. Çdo komunikim institucional i dërguar autoriteteve shtetërore lidhur me gjëndjen arkeologjike të zonës pas ndërhyrjeve ndërtimore.*”, brenda datës 02.10.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 25.09.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi